

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-1
K50

Këngët[“] e para

POEZI
NGA
LETRARET
E RINJ

8141

K 520.



KËNGËT E PARA

Poezi nga letrarët e rinj



SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

Në këtë libër janë përmbledhur poezi të letrarëve të rinj,
të cilët po duken me shkrimet e para nëpër faqet e shtypit
letrar, por ende nuk kanë dalë me vëllim të veçantë.

KUR DEL HËNA MES SHPATESH

Mes shpatesh e bukur doli hëna,
thikë më thikë malesh prerë,
porsi syri i të gjithë brezave
në shenjestrat e armëve përherë,

Rrinë si shqekëz pushke shpatet
prerë konturet me gurë të bardhë
dhe sa herë që del hëna mbrëmjeve
më kujton pranë pushkës një ushtar.

Si frëngji kjo gryka e llangës
u zhurit nga flakët e dyfEQeve,
kur mbi armiqtë «përpara trimal!»
u thërriste komisari djemëve.

Te kjo grykë u kryqëzuan kohërat
ballë për ballë me armiqtë u gjetëm
te kjo grykë ua mposhtëm topat
ne, që luftuam me një pushkë me gjalëm.

Nisin grykat lumin me rropamë
që të blegërijë si dele fushave,
solli gjak kur trimat dje ranë
që dhe këtej të mbinin lulëkuqe.

Shebenikut shkund lulebardha
gurgullima romantike e përrrenjëve.
Mes shpatesh prerë, mbrëmjeve hëna
porsi syri i të gjithë brezave.

ERËRAT FRYJNË PRANË BUSTIT


Në këtë pllajë stinë më stinë erërat fryjnë
harbuar shtigjesh, grykave, zallit
duke marrë me vete buzëqeshjen e busteve,
buzëqeshjen e ngrohtë të Qemalit.

Në këtë pllajë degët e kumbullave mund t'i
shkundin petalet
nga pëllëmbët e erës së malit,
por gjithmonë i bardhë këtu do të mbetet
busti i Qemalit.

Këtu agimet e ditëve vijnë e ngarkohen me drithë
për t'u shpalosur të bardhë
mbi ballin e të gjithë mëngjeseve tonë
si mbi ballin e nënave shpalosen shamitë.

Këtu era fryn nëpër telat e violinës së Qemalit duke belbëuar refrenin e ëndrrës së tij dhe zogjtë nga degët e kumbullave mësojnë këngë për t'i kënduar pastaj nga lartësitë e bigave dhe majat e furnaltave që mban kjo tokë.

Këtu mëngjeset vijnë e ngarkohen me dritë, këtu bilbilat vijnë e mësojnë këngë, këtu erërat stinë më stinë pëshpërisin me mall Qemal, Qemal...



Mbrëmë zbrita nga bjeshkët e bardha të Martaneshit ku 15 ditë e net çava shtigjeve të bardha ku nuk më mërziti shkëlqimi i pambarimtë i dëborës po veç me bardhësi m'u mbush shpirti dhe këngë.

Mbrëmë zbrita nga bjeshkët e bardha të Martaneshit në kolonën e gjatë të marshimit.

Ndonëse supet ishin lodhur nga pesha e rëndë e pajimeve pata dëshirë të sillja orteqet e bardha të dëborës që tek sheshi «Skënderbej» të lozni fëmijët.

Ndonëse nuk solla dëborën e bardhë të malit unë këtë këngë të bardhë fëmijëve u solla që ata ta këndojnë nëpër udhët e qytetit dhe t'u lulëzojë si syhet e pranverës në buzët e njoma.

KUR NDËRROJNË STINET

Së shpejti vjen pranvera
dhe djemptë kur dalin nga dyert e uzinave
i thonë njëri-tjetrit:
— Do të ketë më shumë dieil!

Së shpejti ndrrojnë stinët
dhe vajzat e bukura me shamitë plot lule,
me vështrim nga fushat pëshpërisin:
— Do të korrim më shumë grurë!

Në të tridhjetin vjet
mëngjezet e atdheut janë më të zjarrtë
dhe unë ndjej
si mes zërave te jetës
më i fortë është zëri i Partisë sime:
— Do të ngrihen më shumë, më shumë

flamurë

MOTIVET TONA

Mbi majën e malit bien flokë tē bardha mjegullash,
mbi udhët tona brerojnë notat e gjelbra tē një kënge
partizane.

Ngjeshim vezme, rrafshojmë mirë shënjestrat,
erë barut biem kur kthehem nga poligonet.

Kemi ne motivet tona rinore tē bukura.
motivet me èndërra tē pastra,
motivet e mbushura me yje tē qartë.

Mbi profilet tona rrëshqet dielli i pranverës,
iemi tē thjeshtë dhe tē lumtur që kemi hedhur supeve
pushkët
dhe motivet tona hyjnë aq tē gëzuara
te zemrat e tē afërmve, te zemra e popullit.

DASHURIA PËR HEROIN E PANJOHUR

Me trastën e luftës mbushur me një copë diell
dhe shpresat e së ardhmes,
ai fluturoi si shqipe me pushkën në krah
dhe vrau armiq nëpër male.
Rendi qyteteve nëpër udhë për të derdhur nga ylli
i kuq dritë ëndërrash për fëmijët,
dhe mbeti në sytë e fshatarëve
si fushë e madhe mbjellë me grurë të ri.

AGRON AGOLLI

KANAN DJALEË I RI

(Heroit të Popullit Kanan Mazes)

Kur vinin kobshëm vaporët
mbi detin me valë
u tund e gjithë Barçallaja
të zgjodh' komandant

Ç'u vërvite mbi armikun
si shqipja me krahë
në ball' të kish Labëria,
Kanan trim i rrallë.

Yjet këputen e bien
zjarr përmbi Smokthinë
me një grusht trimash Kanan
godet mbretërinë.

Mes kuvendit të njëzetës
ngrihesh edhe flet:
«Nder' e Shqipërisë, vëllezër
lipset ta mbrojmë vetë!»

O Kanan grykat e thella
të lodhur s'të panë.
«Djemtë i kam zgjedhur vetë —
të gjithë trima janë.»

Garnizon i Kotës shkretë
fara më t'u shoftë
u mbyt Kanani në gjak
nofulla copë-copë.

Ç'bën kështu, more Kanan
t'u prish bukuria
«Ç'ka se mbeta un' pa gojë
të rrojë Shqipëria!»

E nuk tundet jo, Kanani
luan mali vallë?
Si dëbora zbardhët ndër qafa
tallagane bardhë.

Më këmbë u ngrit Labëria
gjithë sokëllimë
djemtë si shkreptima rrufeje
malet seç u nxinë.

Pranë t'u ul Avni Rustemi
të lëmoi ballë,
liria shpatë e flamur
t'u ul përmbi plagë.

Nëpër gërxhe ndeshen retë
majash hekur hedhin
si për sulm mblidhen fshatarët
Kanan të përcjellin.

I vunë çetës emrin tënd,
u bë tramundanë,
pyjet për ty kur dëgjuan,
kryet seç e varë.

Dallgët që vinë nga deti
bregut mërmërijnë,
ligjërimin e ndal era
se fle Kanan tinë.

* * *

U ngrit djali yt i vogël
armët brezit ngjesh
shqotë e bënë partizanët
në çdo grykë e shteg.

Trimërinë këndoi me fyell
barin në mal
këputi dafinë e lule
ia çoi përmbi varr.

Lulëzon bregdet i jugut
portokallet çelë,
Kanan Mazeja nga Shkoza
larg vështrimin tret.

Si vargan vinë fshatarët
pranë bustit rrinë
për ty e përvëlon malli
gjithë Labërinë.

Na merr malli të të shohim
të varesh stanit
siç zbrisnje me djemtë
nga shkallët e malit.

BARDHYL AGASI

BANORET, QYTETI DHE DETI

PESHKATARËT

Era e detit na rralloi flokët,
lodhemi dhe dimë të buzëqeshim,
shitëset në dyqan të peshkut
lodhjen dhe gjëzimin tonë ndjejnë

Duart na i ka çarë rrjeta,
në sytë tanë është zhytur deti,
ditëve dhe netëve të qeta
nga të gjith' më rrall' na sheh qyteti.

Ndaj kur peshqit hidhni në tigan,
lutemi na kujtoni ne më parë,
kur zemë peshq,
dhe ju na uroni
 «Ju bëftë mirë» ne themi,
 «Punë të mbarë».

KUR QESHIN FËMIJËT

Kur qeshin fëmijët,

gjithë lulet e çelura

kapin dhe më tepër fletët,

gjithë buzëqeshjet tona,

rriten sa valët e detit.

Gjithë shqetësimet tona

harrohen menjëherë

dhe rritet dashuria për jetën

më shumë.

Kur qeshin fëmijët,

Atdheut i rreh zemra më shpejt.

J E T E

Babai që dikur të shkulte veshët,
tani kërkon dhe mendimin tënd.
Nëna, që të mbante aq shpesh në krahë,
tani rri në krahun tënd buzagas.
Ti që linde vetë nga një dashuri
me dashurinë tënde do të lindësh jetë.

T E T R A D I U M N I S

N. P. PUNËTOR NË HIDROCENTRAL

Këtu thellë në gjoks të malit
sa pranë më erdhe shok,
teksa djersa më njom ballin
e pistoli gulçon fort.

Jemi larg e na djeg malli
ti n'veri unë në bregdet,
por fuqi që të shpoj malin
prej së largu ti më sjell.

Sa marr turnin vë në ballë
dritën e buzëqeshjes tënde
pra nuk piqemi ne rrallë
jemi pranë si ritme këngë.

TEKSTILISTET

Siç kthen dielli dëborën e malit
në ujvara të kthjellta lumenjsh,
pambukun e bardhë të arave
ato e kthejnë në rrëkeza penjësh.

Derdhën rrëkezat e bardhë të penjve
në lëndina basmash plot ngjyra
mozaik i ndezur pranvere.
Janë ëndërrat e këngët e tyre.

TOKA IME

Toka ime
me nervat e tendosura
të hendeklidhjeve.

Toka ime
me arterjet e transheve
ku rrjedh gjaku i dymilion ushtarëve
ku është mpiksur gjaku i 28 mijëve.

Toka ime
me muskujt e gurtë të maleve
ku thyen kokat e armiqve.

Toka ime
me pulsin e fuqishëm të Revolucionit
ku ndihen të rrahurat e zemrës së Partisë
marksiste.

NË DITLINDJEN TIME

Sonte

i thirra t  17 vitet
ndenja me ta deri nat n von ...
nga secili vit
vola me mall kujtimet
t   mb lat kujtime
q  s'mund t'i harroj.

N  k ng n e zemr s
i shtrydha nj  nga nj ,
l ngu i art  i jet s mbushi at .

**PARA BUSTIT TË MËSUESIT
BABË DUDË KARBUNARA**

A, B, C...
ç'janë këta tinguj,
ç'është ky zë?

Përmes erërave të viteve
zëri yt i butë
vjen tek ne:
A, B, C...

Gjuha jote
si plug
lëroi arën e gërmave shqipe
të përmbytur nga barërat e egra
të përzhitur nga hithrat
të çjerrë nga drizat.

A, B, C...

Xhonturqit

Deshën t'i shkulnin këto germa
po ti nuk i le.

Dhe ata si bishat

ta shkulën mjekrën e bardhë
rrugëve të Beratit
duke të térhequr zvarrë.

A, B, C...

I mblodha sot germat
që si kurorë para bustit tënd t'i vë

K O M A N D A N T !

Vitet mbi ty hodhën varfëri dhe flakë,
ca thënja në flokë e brazda në ballë.
Po s't'u plak jo zemra, shoku komandant,
buzëqeshja jote — trandafil i bardhë!

Mes dhjetra sysh i njoh sytë e tu
dhe zërin mes breshërive ta dalloj qartë.
Herë i rreptë, herë valë në detin blu,
po gjithëmonë baba, o shoku komandant!

Unë do të rend si ushtare kudo në transhe,
do të vrapoj nëpër krisma dhe komanda.
Dhe në se ty do të shikoj dhe aty ku s'je
këtë vizion të ëmbël e të dashur, falma!

TE NJEJTEN KËNGË, TE NJEJTEN MELODI

Unë e di, o vajza me baluke
(shoqja e bankës dje në fëmijëri)
se tani që nata prapa malit struket,
cicërima zoçkash ke në sy.

Ulesh midis nxënësve të tu të dashur
alfabetin u mëson me durim.
Dhe ndonjërit që duart i janë mardhur
ia merr lehtë dhe ia ngroh me frymë.

Kurse unë, në këtë agim të bukur
ndodhem gjetkë, në këndin e kalitjes...
Në shenjestër shenjën e kam futur,
kompozoj këngën tonë të qitjes!

Ti u mëson gërmat fëmijve një nga një,
(Emrat: Shqipëri — Liri — Parti).

Unë u mësoj që syrin prush ta kenë gjithnjë,
a s'është o motër,
e njejtë këngë, e njejtë melodi?!

AFRIKË, MBLIDH DUNAT E URREJTJES

A thua se të paskan frikë për vdekje,

Afrikë?

Më kot zinxhirët mundohen të t'i shtrëngojnë në
fyt.

A thua se ta njohën forcën dhe dunat e urejtjes?

Afrikë,

thikat e agresionit i mprehin pabesish,

a thua se lëkura jote e zezë u kujton

natën e tyre të fundit?

Afrikë,

skllavërisë po i derdh natë e ditë

prushin e rërës dhe kaminat e urejtjes klasore.

Afrikë,

unë besoj tek ti, motër,

unë ty të këndoja,

unë ty të uroj

luftë dhe fitore.

KASTRIOT MAHILAJ

P A R T I

Ky shpirti ynë për ty, Parti,
është si korije që vishet e tëra me lulëkuqe.
Na këndon zemra për ty gjithë ditën në vargje,
e përsëri,
kënga në mëngjes na ndizet në gjokse...

Çfarë s'kemi thënë?...
Dhe kthehem i kthehem sërisht ndaj teje
me dashuri e mirënjohje, o nënë.

Vargjet për ty, Parti,
marrin prushin e zjarrtë të krahërorëve tanë,
për t'u nisur drejt njerëzve të kuq proletarë.

Ritmet e vargjeve për ty, Parti,
janë të rrahurat e zemrës sonë.

MOTIV I LINDUR NË SHËRBIM

Kam vjet që e vëshgoj detin nga posti luftarak.
dhe atë të qetë, kurrë s'e kam parë.

Herë me shqotë, herë me të lehtë,
ai thërmon valët në breg.

Në gjokset tanë do të thërmohen,
ata dhe armët e tyre që akërrohen.

BALLADË E VOGËL PËR KOMISARIN

Çau çeta, çau
në rrëthim e pritë,
plagë e komisarit
ç'po dhemb te të gjithë!

Ka zjarr komisari
oh, ç'po do të ngrihet!
Dëbora mbi ballë
përgjaket e shkrihet...

Buzë e tija shkrumb
zjaarr u jep çdo fjalë.
U ngjajnë partizanëve
si gjuhëza flake:

«Vdekja po më ndan...
Shokë, po vjen liria...
Unë jam një pikë gjaku,
zemra është Partia...»

Flakë e idealit,
që i digjek syve
u fut përmes zjarrit
flakëroi flamujve.

Dhe poet i çetës
ngriti këng' e tija:
«Unë jam një pikë gjaku
zemra është Partia...»

Pushkët, partizanët
ngritën qiellit gri:
Jeton komisari!
Zbrazën breshëri.

Fushës, poshtë në mjegull
i rritej mëria
mali bartë këngën
«... zemra është Partia...»

SHUSHICA RRJEDH E QETË

Shushica rrjedh e qetë
Shushica thur balada.
Ne hymë të parët në valle,
në fëshferitjen e rrepëve,
hymë gjer në zemër
të këngëve labe.

Marrim nga sytë e veteranëve
(nga gjokset me plagë e dekorata)
fragmente epopesh,
fragmente këngësh,
fragmente kujtimesh.
Ne i fusim të gjitha në mendjen tonë,
i ruajmë në zemrën tonë,
shamikaltrat në tribunë këndojnë.

H A P A T

Tek eci këtë mbrëmje,
ngarkuar me paime,
me ngjyra muzgu,
tek dëgjoj
trokitjen e hapave të mia asfaltit,
kujtoj atë natë,
kur nga dritarja e shtëpisë sonë
pash babain që nxitonte në alarm.
Çanta i ngrihej në shpinë
si një kodër e butë,
ndërsa hapat e tij trokitnin rreptë në tokë
Mendova:
Që e qetë agimet të sodisja,
që të rritesha dhe unë një ushtare e mirë,
duhej të ecja në këto hapa.

NË BATERINË BREGDETARE

Këtu në perëndime,
dielli lahet krejt në det,
brigjet kridhen në mendime,
nëpër gurë valët shushurijnë lehtë.
Grykat si sy të gjelbër
përgjojnë në horizonte.
Me tisin e hollë të mbrëmjes
mbështilen fjetoret.
Ndizet në det një dritë e kuqe,
gjithë gaz peshkatarët lundrimin fillojnë.
Si shkëmb qëndron atje artilieri,
mbi shenjestër dy sy vigjëlojnë.
Në to janë kaq të kaltra këto brigje,
në to zbret kaq i qetë perëndimi,
janë ata që s'i tremb kurrë furtuna,
janë këta sy të ngulur thellë tek shkëmbi.

PËR MOTREN E VOGËL
QE KENDON ME ÇIFTELI

Kaq i ngrohtë zëri yt më erdhi
dhe papritur më kujtoi shtëpinë,
kënga jote mbi mua tani derdhi
gjithë ç'kishte, mallin, ngrohtësinë.

Ti përherë ngjit skenat me çifteli,
gëzimet të shoqërojnë gjithëkund,
nga thellësi e zemrës shpërthen me fuqi
kënga jote, kjo këngë e pafund.

Edhe pse s'ke kapur pushkë me dorë
ti me kaq pasion për të ke kënduar,
për vallen e grurit e malet kurorë,
për heronjtë, yjet e pashuar.

Ti akoma nuk ke shkuar në aksione
veç ke përkëdhelur me dashuri shallin tim,
por në këngën tënde tarraca shkallëzojnë,
në të shina shtrohen pambarim.

E dua këngën siç dua poezinë,
e dua, motër, e dua kaq shumë,
ndaj nëpër tela ndize melodinë
ndaj mos e ndal këngën e pafund.

MUÇO MUHO

BISEDE ME GJYSHIN

— *Gjyshit tim Serjan* —

1.

Të prita gjysh të prita
në këngën time të vije
me rruhat e shumta përmbi ballë
me hallet që kaq shumë u thinje.

2.

E hapa derën e këngës së madhe
i përkultur mbi bastun të hyje
të hapësh eshkoren të dredhësh duhanë
e të këndosh një këngë trimërie.

3.

Të prita gjysh të prita
të pritën moshatarët tanë,
të pritën me një tufë me drita
O, gjysh im i shtrenjt qeleshebardhë.

4.

Ti bujk i mirë gjithë jetën ke qenë
këtë tokë, — thoshe — si shpirtin e dua
e përkuleshe fort përmbi parmendë
e mbi të i shkrije gjithë ëndërrat e tua.

5.

Nxjerr kutinë e dredh një cigare
nga thellësia të vijnë mendime të paprera.
Kaq shumë tokë ti s'e pate kurrë
e nis e tjerr ëndërra të reja.

6.

E kështu si ishje unë të futa në këngë
me bastunin, eshkoren me duhan e stërrall
dhe medaljen që more si bujk i dalluar
e mora gjysh dhe ta vendosa këtu pranë.

PRANË JUSH

Të dashur prindër!
nuk do të vij dot në festën e krahinës
radhën kam të rri me syrin mbi pushkë,
po hidhni valle, këndoni të dashur,
unë atje jam, mbaj iso pranë jush.

E dashur!
nuk do vij dot në festën e krahinës
pran teje, mes njerëzve të tjerë
por në kuadratet e blertë përpara tribunës
kërkomë se pa tjetër do të jem.

Të dashur shokë!
ju që s'mundëni dhe ju që do të vini
— Gëzuar festën,
pranë jush më kini.

N E L A S H T E S I

Jataganet ndrijnë në argjend të larë
birbilejtë ku janë vallë kush i ka parë?

Ikën që nga fusha dolën lart në mal
birbilejtë e maleve përmbi male janë.

Ç'po i kërkon beu trimat sypetritë
kudo i kérkoi, kudo zuri pritë.

Populli këndoi: «vanë birbilejtë vanë»
trembëdhjetë birbilejtë armë larë.

Por ata ikën. Vallë ku i panë?
Gjer në kohën tonë vrapi nuk e ndalën.

MYSLYM MASKA

N D O S H T A

Aty ku linda ka pak tokë e shumë gurë.
Toka është e kuqe dhe gurët janë stërall,
një copëz qelli rri varur mbi kokë
sa një qeleshe e bardhë.

Aty ku linda ka pak tokë e shumë gurë.
Toka është e kuqe dhe gurët stërall,
ndoshta nga kjo buisin lulëkuqe
ndoshta nga kjo
në gjoks kam kaq zjarr.

ARMIQVE TË KLASËS

E dimë!

Pik gjaku s'u ka mbetur në zemër
si lepujt flini syhapur

në ankth e frikë

kokat jua mbajmë nën thembër
dhe idetë

dhe ëndrrat

dhe mishtë.

Ju njohim!

Juve, më finokët kameleonë
që vërtiteni e nuhasni si zagarë,
rrëmihni e gërmihni

me dhëmbë e me thonj

kufomën e kapitalit
groposur në varr.

E dimë!

gjaku ju është mpiksur në zemër
Shtireni: «Të velur», «të lumtur»
kokat jua kemi nën thember
dhe iluzionet
për «parajsën e humbur».

L I R I K E

Hëna kërthiz qielli varur përmbi kokë
Ç'na dehu vlagu tokës si raki e fortë.

Na dehu dashuria s'ka përse të druhem

Kur bymehen pemët, kur shpërthen pranvera
shpupuriten ndjenjat si flokët nga era.

Ecim nëpër jetë ëndërrat tonë sjellim
dhera nëpër gishta dhe flok përkëdhelim.

Furshulluan gjethet krah pëllumbash shkundën
mbase të kujtohet mbrëmjen që u takuam.

P E I S A Z H P R A N V E R O R

Pranvera mbi tokë prap shkel
e sythet nxjerrin gjuhët petale,
pas banjës dimrit pyjet po veshin
këmishën e gjelbërt në male.

Pranvera plot tinguj, gjindezur
kaq e moçme... prap përtërihet,
hëna me flok' resh të pakrehur
diku mbi liqen fillon krihet.

K A M N J O H U R

Kam njobur shumë njerëz të mirë në jetë
të dhimbshëm si pleqtë, të fortë si metalet
bujq, gjeologë, poetë,
por tek punëtorët gjeta jetën e vërtetë
aty dhe të urtët filozofë thinjeshin.

M E K A N I K U

Ajër i ngjethur, toka kérck' e ngrirë
era gjuh' akull na lëpin fytyrën
jo të gjithë në kohë të vështirë
thonë: asgjë, thjesht po bëj detyrën.

Kyçi të ka mbirë në dorë
sikur ta kesh gisht të saj të gjashtë,
kérkon difektin, dergjesh mbi motorr
bymbyer me graso, që shndrin si mëndafsh.

Të falenderoj, do më thuash: Asgjë
nuk gabohem nëse do të them,
shpirt i vockël s'është më shumë se baltë,
jeta zjen në shpirtrat e mëdhenj.

Kyçi të ka ngrirë në dorë
sikur të jetë gisht i saj i gjashtë
i djersitur, memecin motorr
ti e bëre përsëri të flasë.

KUR SHOH LULKUQE...

(Margarita Tutulanit)

Pemët shkundin zogjtë në hapsirë
 gjiri i tokës pikonte manushaqe
 trupi i saj u mbush me trëndafilë
 currile gjaku i rridhnin në faqe.

Vello erës trupin ia mbështolli
 rreze diellit me gjakun u mpiks
 një qershi ca petale hodhi
 sikur deshi plagët të ja lidhë.

Një copë re t'u gjend për qefin
 plot dhembje u hap një rrisk toke,
 po ku mbante varri dot një bubullimë
 si fjala e trimëria jote.

ODISE GORO

DHE, SI SHKËMB MBI SHKËMB, U NGRITE!

— *Kushtuar nënës së një dëshmori* —

Një djalë kishe, ja dhe çetës,
se e linde për barot!
Moj nënëz me shpirt — furtunë,
kur e puthe, s'derdhe lot!

Vinin shqipet poshtë fshatit,
zbrisnin yjet që nga mali!
Ç'i pyesje — nënë trime:
«Vallë, ma zbardhi faqen djali?!»

Eh, seç sulej partizani!
shtrëngatën me gjoks e çante!
Trim të rrallë e njohën shokët!
Barotin me grusht e hante!

Erdh' liria në çdo vatër!
Atë ditë çdo gur u tund!
Shqipëria ballëlart,
nisi vallen e pafund!

Nënë, seç dole te praku!
Prisje djalin... por s't'u kthye!
Kënga, që mbaje në buzë,
as t'u mek e as t'u thye!

Shaminë — gjak nxorre nga gjiri.
Nëpër erë, seç e vërtite.
The: «Partia të na rrojë!»
Dhe, si shkëmb, mbi shkëmb,
u ngrite!...

PËRÇJELLJE...

Bie një dajre, shkul vëndin një gënetë!
Përcjellim djemtë! I nisim pér ushtarë;
nga shpirti i nënave — urim' i pastër rrjedh:
si ujërat — kristal, në një ujvarë...

Përcollëm djemtë, që i pret detyra!
I përshëndetëm me zjarr, të përmalluar!
Ç'i përshëndetën — limonat dhe ullinjtë,
nga pesh' e kokrrave — kërrusur e rënduar...

Ç'i përshëndetën tarracat dhe bregoret,
që gjoksit mbajnë një gjelbërim të ri!
Ç'u tundën dorën transhetë dhe llogoret,
ku nat' e ditë — çdo bujk — zgjuar rri!...

PEISAZH NGA BREGDETI

Në zemër të shkëmbit lulëzon limoni,
në zemër të shkëmbit ulliri hedh shtat,
në zemër të shkëmbit i kemi pozicionet
përballë tramundanes me shkulme e tallaz.

SE SHUSHURIN VALBONA

Gishtrinjt e Norës vallzonin mbi tastierë
dhe «Valët e Danubit» vërshonin n'autoditor...
Përhapnin notat kaqë embëlsi,
sa çerdhe ngrinte për to çdo kraharor.

Por kur e dridhte Gjergji çiftelinë,
të tjera rrahje provonin zemrat tonë,
Ç'na flisnin sytë me gjuhë vetëtime:
«Shtraus... na ndjeni, shushurin Valbona!»

PETRAQ RISTO

KËNGËTARIT POPULLOR DEMIR ZYKO

Pikonin gjak rrufetë
si të çara me thikë
kur në malet e Gjerbësit
Këndoje Demir Zyko.

Dhe ish kënga jote,
si melhem për plagën
kënga ish si toka
mbushur plot me vlagë.

Këngën, vetëm këngën
kishe pasuri
Ndaj ia mirrje ëmbël
o për Shqipëri!

P L A K A T

U mundova t'u bëja portretin plakave shqiptare,
të gjeja diellin që lindi në rrudhat e ballëve
të shikoja djepét që lëkundeshin në shpirtin e tyre
dhe ninullat që buronin nga buzët e tyre.
Plakat më kalonin pranë me boshtet e drunjta
duke tjerrur dhe duke rritur lëmshin e viteve
dhe shikoja se kishte shumë mall
dhe shumë fjalë të urta
në sytë e tyre.

U mundova më kot të gërmajoa
në botën e plakave shqiptare
e si mund t'i nxirrja të gjithë ato thesarë:
Përrallat që pikonin si hojet e mjaltit në verë,
urimet e bardha në ditët e dasmave
të djemve dhe vajzave
në ditëlindjen e Partisë dhe të shokut Enver,

këngët dhe vallet

(vallet rrethore si muret e kalave)
a mund t'i mblidhja vallë të gjitha menjëherë?

Dhe plakat më hynë në dhomë,
dhe u ulën këmbëkryq në mindere e qilima
si një det i thellë duke numëruar

pasqyrimin e yjeve dhe viteve.

Dikush thithte duhan, dikush ëndërronte e qetë
dhe papritmas gjyshe Vita m'u fanit mes tyre;
«Mos u huto nipçe, por bëna kafetë...!».

Eh, moj plaka, plaka të mira!
Gjithë ditën kërkova e kërkova,
dhe gjeta gjithçka të bukur te ju.

A F R I K E

Ti kurrë s'mund të rrish e heshtur
si nën piramida faraonët,
ndaj bubullimat e tua parreshtur
çajnë e çajnë qiellin e kohës.

Ti më e shkathët se luanët,
më e qëndrueshme se devetë,
në shpirtin tënd zgjohen vullkanet
e shekullit njëzetë.

Në shtatin tënd liria rritet
dhe ti do t'jesh një nënë e lumtur,
do të ngrenë kohrat obeliske
si nëpër ëndërrat e Lumumbës.

Në gjakun tënd vrapon liria,
vrapon e ardhmja afrikane.
Ndihen në qiel lumbullima
kur te ti gjëmojnë tam-tamet.

B E T I M I I M

Duke u përkulur mbi varrin e një partizani do të
më gjeni në çdo 5 Maj,
duke prekur kreshtën më të mprehtë do të më gjeni
në çdo 29 nëntor,
duke ndjerë zemrën e atdhetarëve do të më gjeni në
të gjitha ditët,
duke përqafuar nënën time do të më gjeni në çdo
mbrëmje,
duke ecur me të dashurën time do të më gjeni disa
çaste,
duke vigjeluar të kufijtë e atdheut tim do të më
gjeni gjithë jetën.

KUR IKU NGA VLORA

Me kokën të kthyer përgjysmë nga ti,
me një pjesë zemre nëpër rrënje ulliri,
me një valë përplasur përmby sup e gjoks,
me një puthje lënë ku flë Teli Ndini...

Sa zgjerohet deti kur iki nga ti,
sa skuqin gjethet, pjergullat e tua,
sa shpejton era të arrijë tek unë,
të më sjellë pas fjalët që më thua.

Me kokën të kthyer përgjysmë nga ti,
shkrirë zemër me zemër, edhe sy më sy.

P R A N V E R E

Eshtë stina që i kërkojmë më shumë se çdo tjetre, që e kthen djersën dhe gjëzimin në lule, bukë, fruta, nën qiellin e saj mbledhëset e portokajve jugorë nesër do të kenë dasmat e tyre të bukura.

Eshtë stina që pret rritjen dhe pjekurin' e ditëve
të ardhshme,
sic pret gruaja dikush t'i vijë e të lehtësohet
nga pesha e saj,
të gëzohet për belbëzimet e pafajshme të fëmijës.

THREE SKETCHES

I dua drurët për forcën e tyre të pashtershme
dhe trenat për shpejtësinë e tyre i kam dashur;
i dua dhe tani,
i njoh portokallet nga gjelbërimi i freskët
dhe Jonin nga gjerësia blu e ballit të tij.

Shpeshherë i kam lëmuar këta drurë të përjetshëm
kur jam kthyer te shokët nga një rrugë e largët,
sytë e mi më të kaltër janë bërë për dikë,
ndoshta për prindërit,
ndoshta për të dashurën...

NE MËNGJESET E FUNDIT

Në çastet e ikjes këtu gjithçka më duket e shtrenjtë
që nga ndërtesat, lulishtet gjer te sheshi i qytetit
të nxituarit e orës 8 në udhën prej asfalti,
të gëzuarit para fakultetit.

Këtu kam qenë dhe do të jem i pranishëm kudo,
tek të gjithë stolat, tek të gjitha dritaret,
tek çiltërsia e të gjithë djemve çapkënë,
tek ndrojtja e ndershme e të gjitha vajzave.

Por s'trishtohem në ikje, lë pasardhës të tjerë,
të cilëve u kam folur, u flas përzemërsisht,
ngaçë e dua shumë këtë qytet të madh,
në të do të jetoj përjetësisht.

KUR JAM ME TY

QADIGJINË BUR

Ne më të bukur bëhemë duke u dashuruar
nën degët e agrumeve që na njohin në breg,
dallga tek dallga shkrihet, puthet,
zemra tek zemra njeh rrahjen e vet.

Unë e di se sytë e tu të mëdhenj e të bukur
përjetë do të rimojnë me të kaltërit sytë e mi,
zemra sjell në buzë ato fjalë që ndjen prej kohësh
deti sjell në breg atë ngjyrë që ka në thellësi.

SEFER PASHA

SEFER PASHA

GADISHMÉRI

Mbi ca gurë tē murmë, mbrëmë u ulëm
në qafën e malit tē zhveshur,
era shkëmbinjtë kërkonte tē shkulte,
retë lotonin pa rreshtur.

Hëngrëm bukë në errësirën e natës,
dhe kur rrufeja shkrepte përbri,
shihnin shokët, mbështetur pas armës
me gishtin në këmbëz në gadishmëri.

SHESHI I PARTIZANEVE
Një shesh i kufitarët

ovës së lirë që nuk ka
dëshirat e tij të vënë

SHESHI I PARTIZANEVE

sheshi i kufitarët

sheshi i kufitarët

Eshtë një shesh sipër në mal
po s'ka rrugë për atje,
rrotull ka shkëmbinj e stërrall
mbi të një shtëllungë re.

Sheshi i partizanëve quhet,
ai shesh në mal të lartë,
kufitarët në dy shtigjet
rrinë si një brez i zjarrtë.

Pse ky shesh ka këtë emër,
kufitarët mirë s'e dinë,
shohin veç ca pozicione
mbuluar me trendelinë.

Një bisedë me komisarin
ndoshta patën partizanët

dhe një këngë rrrotull zjarrit
e kënduan për të rënët.

Tek ky shesh i partizanëve
ku dhe bora vonë shkrin,
në të vjetrit pozicione
kufitari natën gdhin.

Ismë është rëndësi që është
një sëmundje e që
llogaritë e çmimit që
sunt zgjedhur që është idh
dhe që do t'ju marrin.

Jetimi avësuesi i llojave
që janë të lartë kanë
çmimin e çmimit që
sunt zgjedhur që është
një sëmundje e që
llogaritë e çmimit që
sunt zgjedhur që është
një sëmundje e që
llogaritë e çmimit që
sunt zgjedhur që është
një sëmundje e që
llogaritë e çmimit që
sunt zgjedhur që është

një sëmundje e që
llogaritë e çmimit që

KUR U NGJITA NË MAGULEN E KALTËR

Mendja ime ende nuk e dinte ç'ishte bota,
ende nuk isha ngjitur në Magulë.
Viçin për litari tërhiqja tërë ditën
natën yjet numuroja mbi mal.

Sytë më lodheshin duke shikuar tej maleve,
atje ku babai me fshatarët do të blenin misër.
Bija sa herë përmbyss buzë ledheve
dhe ëndërroja këpucë për nesër.

Një ditë me shokët
në Magulen e kaltër
u ngjitëm për të parë dynjanë.
Kjo ishte maja më e lartë në Mallakastër,
nga ne thirrëm
«Ja fshati ynë Kremenar!»

U rrita dhe u ngjita majë më majë,
socializmi më dha më tepër se këpucë e miell.
Tani vendlindja ime mua më ngjan
si një beden i Shqipërisë kështjellë.

D R I N I I D E V I J U A R

Ku është Drini? Shtrati mbeti bosh.

Ecin mbi ranishten e bardhë punëtorët
u kumbojnë hapat si në galeri antike.
Lexohen tragjeditë e njëmijë shekujve
përjetësisht nën harqet e tuneleve.

Punëtorët mësuan të deshifrojnë
moshën e pasaktësuar të lumenjve.

Në shtratin e djersës që rrjedh pika-pika
shtratin e ri ka Drini i ri,
Drini i tuneleve të dritës.

IMAZHE PËR FIERZËN 1977

MAUTGRUHI I INJËVIT

Ja, po ikin makineritë me uturimë
punëtorët e fundit po largohen me skicat e një
vepre tjetër në duar,
prapa po mbeten netët e tyre të shqetësuara,
ditët e tyre të stuhishme.

Ja, po largohen punëtorët e fundit
për në një hidrocentral të ri
letrat për këtu më të rralla do t'vijnë
gjithçka do të jetë në heshtje madhështore
vetëm ditët punëtore do të vënë në lëvizje
makineritë me bubullimë.

NDRYSHE SI MUND TË JESH POET?

Vargu im është si ato vajzat e kantiereve
të pozojë nuk di, flet natyrshëm, pak shkurt.

Në diskutimet poetike flet me zërin e klasës
hapin ndoshta e ka pak të shpejtë,
është shpesh syskuqur e i pagjumë
se u shkrua pas turnit të tretë.

Ai mbrëmë në ballë të galerisë
foli direkt me Partinë.

Partia ishte veshur me kominoshe,
dhe hapat e saj e bënин të gjëmonte galerinë.
Partia bisedon me ne deri vonë
pastaj shtrohet mbi hartat industriale
dhe piketat e veprave shënon me dorë.

Vargu im vjen pak i heshtur
ai s'ka qënë në universitet,
po ai u fut përpëra atje ku do t'futej Drini
e ndryshe si mund të jesh poet?

19. Mësuesit e shkollave

everëzimai e dëshirv ota ka bërë mi uygjaz
Bashkia e që mësuesit e shkollave

aspirantët e shkollave
që qëndrojnë këtu që e mësuesit e shkollave
Bashkia e që mësuesit e shkollave

aspirantët e shkollave
që qëndrojnë këtu që e mësuesit e shkollave
Bashkia e që mësuesit e shkollave

SPIRO SOTA

Arbiend e 5. deň

Iselen sej bëgħid
is-sit u faru u ġie ħażżeġ i clu
mido-fax u tħaliex-tnejja
ta-piċċu u tħalli u tħallix

KOMISARIT BIRČE

(B. Sinomatit)

Erdha këtu, ku egér fryn veriu
si një këngë e lashtë trimërie
e mes telave tē sharkisë, tē gjeta ty,

komisar

ty shkëmb i ardhur prej labërie.

Shkélzeni qeleshebardhë vështron Tropojén,
më vështron mua që sapo erdha nē veri
dashurinë dhe dhimbjén

pēr ty, komisar,

e derdh mbi tela,

e derdh mbi sharki!

E qeshur Tropoja,
nē valle hidhen bjeshkët

dhe kënga pér ty,
është e bardhë.

Këngët dhe malet
nuk i gërryejnë as ujrat as vitet
përjetësisht ke mbetur
aty, komisar.

JANË Rritur pishat e tua resmi

U bënë vite që ti s'po del të shohësh pishat...
janë rritur e shtatet e tyre të drejtë,
përkunden ngadalë nën erërat e pranverës.

Pyjeve u ngritën qyteza të reja sharrëxhinjësh,
ku thuren ëndërra të reja e dashuri të reja.
Nesër prej tyre Resmi,
do t'lindin silvikultorët e ardhshëm dhe poetët.

Janë rritur pishat e tua Resmi
e nga halat e tyre kullon vesa e mëngjezit
si kristale të ndritëshme...

Edhe kur të bëhen pyje shekullore pishat e tua
e sharrëxhinjtë të ngrenë këtu një qytet të ri
njerëzit, që mund të mos e dinë më emrin tënd,
kur të prekin trungjet e tyre,
do takojnë dorën tënde, Resmi.

DHENTË SHTEGTOJNË DREJT BJESHKËVE

U tha bari i tokave, baca Azem. Erdhi vera.
Tashti këmborë e zile, një mëngjez, do ikin drejt
majave.
Në sytë e tu, e shoh,
po dridhen të gëzuara ditët e qumështit dhe fyejve

Udhë e mbarë baca Azem!
Fyelli yt në Sylbicë e Dobërdol, do t'ndihet netëve
plot yje
duartë e tua të rënda do t'mbështeten mbi kurrizeit
e butë të qingjave,
zemra jote e mirë — në mirënjojen e njerëzve.

Udhë e mbarë baca Azem!
Dhentë që shtegëtojnë drejt bjeshkëve
u sjellin një motiv të ri vargjeve dhe fyejve.

M E N G J E S

Gishtérinjt e diellit
u zgjatën mbi xhamar,
trokëllijnë

Një foshnjë e filloi ditën e parë të jetës
e tashti po fle në gji të nënës.
(Përtej rrugës sonë
fillon rruga e tij). Përtej kufive dhe rrugëve
dhe èndrrave
u zgjat udhëtimi ynë.

Çohu!

Gishtérinjt e diellit
u zgjatën mbi xhamat,
trokëllijnë.

SYRJA XHELAJ

PALLZHVESHUR...

Nga gjoksi toká thirri,
në fletë era ndali,
ku je o Rrapo trimi,
ku je Rrapo Hekali!

Dhe oshëtiu bregu
dhe oshëtiu mali.
Ku je, o Rrapo trimi,
ku je, o Rrapo Hekali.

Si një hienë armiku
Atdheun po ta zhduk,
ky popull éshtë i varfér,
ky popull nuk ka bukë.

Në bankat e Parisit,
ky popull nuk ka çeqe,
veç n'hatullat e vjetra,
syzgjuar mban dyfeqe.

... Dhe rendi Rrapo trimi
dhe heroizmin mbolli
çdo vatës si një bir'
e priti e përcolli.

Pas tij bijt e shqipes
posi stuhi vanë,
luftuan mbi armiq,
me shpat'e jataganë.

Veç ja tek para shkontakte,
gjëmonte si rrufe,
një plumb na e merr trimin,
e na e shtrin përdhe.

I shtrirë thërret Rrapua
me fytyrën e qeshur:
Lirinë gjithnjë vëllezër
kërkoni pallëzhveshur...!

NUK HARROJMË

Nuk kemi si të harrojmë Borovë
krismat e parabelit të urryer që tej për tej
çanë shpresën tënde në djepet e fëmijëve,
të njomë,
dhe sytë e bukur të motrave që u vranë,
dhe ballët e menduar të nënave,
dhe vështrimin krenar të etërve,
nuk i harrojmë.

Nuk kemi si të harrojmë Borovë,
gjuhët e flakëve të tua të dridhshme
që ngjiteshin lart
në qiellin e paanë.

Nuk harrojmë, u hakmorëm.
e tok me lirinë zbritëm një ditë
 prej maleve të lartë,
Në brazdat e gjakut tënd Borovë,
që rodhi vatrave,
vitet tona të lavdishëm hodhën shtat.

Nuk kemi si të harrojmë Borovë,
urët që dikur të dogjën ty —
 e dimë,
në duart e imperialistëve e revizionistëve
ndezur rrijnë.

BACÈ SOKOLI

Ja ku éshtë baca
duke i rënë çiftelisë.

Në doni të dini
për zambakët e bardhë të trimërisë
çelur në zëmrën e malësorit,
për hingëllimën e kuajve,
për rrahjen e tupanëve që lajmëron betejën,
dëgjojeni atë këngë!

Dëgjojeni atë këngë,
mos e harroni!

E në doni të dini se ç'dashuroi më tepër
shihni të shtatë plagët në gjoksin e tij,
baca,

ecni nëpër shtatë udhët e çelura
nga gjoksi i tij.

Ja ku është baca duke i rënë çiftelisë.
Lidh ditët tonë me ditët e stuhisë.

VANGJEL KOZMA

HEROI DHE BUKURIA

Vasil Laçit

Laku lëkundej,
ishte e njëjta erë,
që flladiste rivierës agrumet,
që rrudhët faqen e detit përtej
dhe pjalmin e shkundte nga lulet.

Ta dinte era ç'do ndodhë pas pak,
do ngrinte në këmbë stuhitë,
me vete do merrte acarin e thatë
dhe dimrin e gjithë Shqipërisë.

Ti hipe i qetë mbi fronin e drunjtë,
xhandarët përreth rrinin strukur,
fjala e fundit!
— Një krëhër, — iu the —
dua të vdes i bukur!»

G E R N E T A

Nga gërneta jote Vjosa rrödhi
rrahën dallgët brigjet e kabave,
ra dëbora mbi folenë e zogjve
ngrinë strehët dhe vijat e arave.

Pa u duk pastaj sikur nga vatha
dolën qingjat majës së Papingut
pllajave me çaj dhe blegërima,
iu shkri zemra Dilaver Bariut.

Në çdo prag, në çdo sofat të gurtë,
ku bie erë rrush dhe erë dasme,
le nga zemra jote e gjerë shumë
copa kënge, kaba përmetare.

PARTIZANIT ALEKS

Ish ditë dimri, ish mëngjes
mbi male vareshin retë
kur u vra partizani Aleks
atje në shkëmbinjt' e sertë.

Nga dhembja lotoi dhe bari
gushëkuqi këngën la në mes
në heshtje u ul komisari
kur u vra partizani Aleks.

Kënga nga gjokset u ndez
dielli po shkrepte nga mali
kur u vra partizani Aleks
— Dalngadalë po vinte behari.

GURË DHE THËLLËZA

Në këta gurë rriten thëllëza
i keni parë si fërfëllojnë mbi burime?
e rrahin krahët në male, në rrëza
në mbrëmje të vona dhe agime.

I keni parë ju thëllëzat, vallë
kur grumbuj-grumbuj mbi gurë rrinë
dhe këngën lënë në fijet e barit
dhe gjer në fshat kur duan vijnë?

I keni parë ju thëllëzat tona
kur zbresin në verë mes arave
dhe rrinë në mbrëmjet e vona
buzë këngës e qeshjes së vajzave?

O, i keni parë thëllëzat, patjetër
kur krahët nderin në agim.
— Kush tha se gurët tanë dhe shkrepat
s'e njohën vallë bukurinë? . . .

VAJZAVE NË VALLE

Kështu ju pafsha vajza
mes gazit e valleve
ju këndoftë zëmra
përherë festivaleve.

Ç’ma përdridhni belin
lehtë e ngadalë
njëra flet me sy
tjetra me qepalle.

Vallen më të mirë
seç e kanë marrë
O, gazi nga buzët
rrjedh si ujëvarë.

Kështu ju pafsha vajza
mes gazit e valleve
ju këndoftë zëmra
përherë festivaleve.

LIRIKA E NËNËS

Në fshatin e largët me njëzet shtëpi
që të parët e quajtën Postenan
rron nëna ime me emrin Agathi
që gjashtëdhjet vjet mbi supe mban.

Më përçolli flokëthinjura në institut
buzë një mëngjezi të bukur, të bardhë
dhe dorën e butë ma hodhi në sup
«Mirëupafshim bir — hap sytë, djalë!»

Dhe duart ç'm'i ngrite nga larg
kësaj here jo si çdo ditë.
Në sytë e saj më i bukuri varg,
në sytë e saj më e ngrohta lirikë.

Këto nënët tona ç'i djeg malli
ndaj emrat tona zenë shpesh

dhe thonë të lumtura: «përcolla djalin»
si nëna ime këtë mëngjes.

Dhe duart q'm'i ngre nga larg
kësaj here jo si çdo ditë,
në sytë e saj, më i bukuri varg,
në zëmrën time dhe kjo lirikë.

KUR ERDHE TI....

Kur erdhe ti atëherë ish' dhjetor
në kantier frynte erë e ngrohët.
Kish' plot një javë që binte borë.

Atë ditë ti hyre si një fllad i lehtë
duart e vogla të gjithëve na i zgjate.
S'më harrohet Aliu, mjeshtri i vjetër,
kur dorën e ashpër të vuri në faqe

Dhe të dha xha Aliu një këshillë
te hyrja e barakës së vjetër.
Ku di unë ç'të tha ai burrë i mirë?
Po ndonjë shaka ka bërë pa tjetër.

Ndërsa ti queshe bashkë me ne,
poezisë sonë iu shtua dhe një varg.

Kantierit tonë iu shtua dhe një e re,
një muratore që vinte nga larg.

Kur erdhe ti atëhere ish dhjetor,
në kantier frynte erë e ngrohët,
ndonëse kish një javë që binte borë...

SIRENA E PARË NË MALLAKASTER

Një erë e fortë më shpërtheu dritaren,
fletët e poezeve më ngatërroi,
nga jashtë hyjnë gjëmimet e sirenave
dhe bëjnë të ushtojë dhoma ime.

Unë jasht rend,
Luginës së Gjanicës mbushur me trena;
sa shumë njerëz!
Shina pa fund...
Po zbret Mallakastra
ngarkuar me naftë e bukë,
këngët e valët përziem me sirenat.
Naftë e Mallakastrës ku s'do të jetë,
ari i zi, ngarkuar me cisterna.

DESHA TË THOSHJA DİÇKA

Unë doja të thoshja diçka
dhe rrija i heshtur,
ndërsa dëgjoja kërcitjen e druve që digjeshin,
për mes të qeshurave hokatare të shokëve,
Doja të thoshja diçka,
tek shikoja përmbi supin e shokut tej në
horizont
si thërmohoj kjo natë janari,
me pritjen e lindjes së përditëshme të diellit,
që, asnijëher s'na u duk e përsëritëshme,
asnijëher e ngajjëshme me lindjen e djeshme.

Unë doja të thoshja diçka,
për bukën e montatorëve që sapo lanë turnin,
tek theket përmbi sobë,
për aromën tepër të ëmbël,
dhe duart e mëdha që e ndajnë në katersh.
Për këtë natë montimi,

për kraht e ëndërrave montatore,
që rrahin pa prerë drejt lartësive të pesëvje-
çarëve

Për Myrtezain heroin e punës socialiste,
24 orë pa u ndarë në skelat e sferave,
për tetëmbëdhjet vjeçarin Ylli,
që, ngjitet sot për herë të parë në lartësi,
për kantjerin që pret i zgjuar mëngjezin,
për ditën e sotëme,
unë doja të thosha diçka.

V I T I 1920

Jo, nuk është deti i Vlorës që gjëmon
Labëri,
janë burrat që thërrasin
trimat me shajak hedhur supeve
me kasature,
e dy tri plumba
me Selam Salarinë tek derdhen tutje...

Jo nuk janë rrufet,
janë vështrimet e trimave,
nuk janë gjëmimet,
janë këngët e shqipëtarëve
që do të djegin himne perandorakë
dafina kurorash,
stema pushtuesish,
kënga e Lebërve një epope e tërë ndezur flakë.

Jo nuk janë lumenjt e rrëmbyer
janë trimat e Labërisë me flamur në duar.
Vallja e tyre me fustanella si dallgë e shkum-
bëzuar.

në ballë i puth fitorja,
në ballë i puth lavdia.

C E N T R A L I S T E S

Dimër.

Valle stuhish dhe borërash:

— Alo, alo, alo!

Mespërmes dimrit thirrja jote;

Alo!

Ti buzëqesh

me dy kufje të buta si dy duar të ngrohta
të hukatura nga frysëmarrja e mijëra

njerëzve,

Alo!

Sinjalet cijasin në kufjet e tua

si zogj të guximshëm me haberin në sqep,

Alo!

Diku në largësitë e bardha të kësaj dite

lindi një fëmijë,

diku

u pre shiriti i një vepërë të re.

Diku

u hap një rrugë,

një vapor i ri sapo doli nga porti,
një ansambël niset për turne në Veri,
aksionistë të rinj nisen për në Jug.

Alo!

Sa afër qënkan njerëzit...

Ti dëgjon frymëmarrjen e tyre
dhe kokën e bukur, të duket, sikur ke mbësh-
tetur mbi supet e të gjithëve.

NË UDHEN E DIJES

Vendi po mëkëmbej
si foshnja nga djepi,
ne kishim besimin
më të gjërë se deti.

Zbrazëm shtëpitë
e nxorrëm kulakët
«C'na bëtë leckamanë
na e vutë flakën».

Në dyert e tyre
u shkrua shtrembër:
«Kjo është klasa e parë»
eh, q'e madhe ëndërr!

Ëndërrova unë
për fustan të bukur
«Bijë, s'kemi», — tha
nënia me të lutur...

«Po një çantë, vallë
nënë, s'do t'më gjesh
e qepur me spango
qoftë dhe me leckë?»

C'qe ajo mbasdite
s'e harroj kurrë,
«Të më bëhesh, bijë
vajzë me kulturë».

Fustanin e saj
e prishi nëneja
dhe shaminë e ballit
të bardhë si reja.

Dhe më bëri nëna
nuse atë ditë
që bijtë e kulakut
t'i shqyenin sytë.

Babi më dha lapsin
ruajtur nga mali,
babi që mbante
yllin tek balli.

Futur në gëzhojë
ma vari për mezi
fishhek, mbi padijen
lapsi im të ndezi...

Q Y T E T I I M

E si mund ta kuptoj qëndresën e qytetit tim
pa çapet e rëndë të burrave me gjerdanë,
pa ashpërsinë e gurit dhe peshën e kalasë
pa grinë e çative që u kthyen në istikame.

E si mund të kuptohet burrëria e qytetit tim
pa këmbën e përgjakur të Çerçizit mbi piedestal
që ia grinë kalldrëmet dhe celfat e strallit në male
mezin ia vrua dhe përgjaku gjerdani?

Akoma sofateve dalin plakat me shifonet e zinj
dhe presin Bulen që i queshte nuri dhe ndrisnin rrugët
presin Bulen
që fjalët i dalin nga fëshfërima e rrapit
që sytë i shkëlqejnë mbi piedestal
në gurin që e prumë mbi supe nga Mali i Gjerë.

E si mund të kuptohet Gjirokastra
pa avllitë e paqme dhe pragjet e bardhë nga
gëlqerja,
pa pikat e pastra të shiut që krijojnë ylberin,
pa mjegullën e dendur mbi xhame dhe degët e mënave
pa vallen e kaldrëmeve me gurë të thyer nga shpellat?

Rinia e qytetit tim ka mbirë mbi lashtësinë e qytetit
të moçëm
me gjerdanin e veprave dhe oxhakët ndezur
me shëtitjen e vajzave të bukura si lule të mbira
në rrugë,
qyteti im me rrënjet e sertë te lashtësia
me degët e blerta tek dritaret e kohëve të reja.
Qyteti im është një karakoll, një mal, ku çdo banor
i ri e i lashtë
këmbëzën e pushkës e ka patur si gishtin e gjashtë.

E R D H I P R A N V E R A

Erdhi pranvera.

Lumenjtë u mbushën me ujin e borës
prilli me bilbilë.

Truma zogjsh me ciklone lëvizjesh si flokë
bore
hyjnë nëpër dhomat tonë
çukitin në parvazin e dritares,
bien «pikjatë» mbi kokat tonë.

Nga sqepi i verdhë
dalin fillimet e pranverës
na kish marrë malli për korin e tyre
i sodisim
kur sqepin kruajnë në pragun e derës.

Hyjnë, dalin
dalin, hyjnë
në ullirin përballë ngritën banesën
dhe cicërojnjë...

Erdhi pranvera.
Në ara fshatarët hanë drekën,
bajamja e sapoçelur
kokat që avullojnjë i spërkat me petale të
bardha,
vajzat çapkëne
ngatërrojnjë në flokë dhe bishtaleca
fijet e pranverës.

NET PLUGIMESH

Flinte fusha e lodhur, mbuluar nga tisi i natës
nën ninullën e traktorit të Mediut dhe cijatjes
së zogjve te lisat.

Frynte erë edhe tymin e skapamento e hidhte tej
si flokët e vajzës së zgjidhur nga fjongua.

Mërdhinin zogjtë në fole mbledhur kokë më kokë
si kokrrat e lajthisë në degë
futur sqepat nën krahë dhe mbuluar me bar.

Mediu këndonte një këngë për Fatimen e bukur
që e pret në parvaz me sytë si dy yje
me fytyrën mbështetur në mollzat e gishtave
dhe mendon...

Nuk e fton gjumi Fatimen që sodit fushën,
zogjtë i mundi gjumi tek lisi,
dhe çapet e nënës nuk dëgjohen më nëpër shtëpi.
Fatimja pret të kthehet traktori
dhe dritat e tij i duken si dy sytë e Mediut.

Era bie nga larg fjalët e Mediut,
Fatimja ngre dorën dhe uron:
«Natën e mirë, ju fusha».

Ç O B A N I

Sevdalli çobani ia merrte me longare
qepur xhep në shark mbante abetare.

Pikë-pikë nga lulet se c'pikonte vesë
përmbi abetaren, eh c'i binte djersë.

Po ja merrte këngës se i digjej xhani,
vargje të Naimit këndonte te stani.

Me dru nga të panjës me erë trëndelinë
në sëndyk e futi libër pasurinë.

Kapakun e lau me qumësht, me dhallë.
Do ta gdhend Naimin, bilbilin e rrallë.

Deshi bagëtinë, deshi bujqësinë
sëndykun e trimit, që ruante dhitë.

Me shkelm e goditën xhandarët një ditë
sëndykun e trimit që ruante dhitë.

Radhë-radhë xhandarët zaptuan male
«Erdhë për të mirë, a të keq vallë?».

Duarlidhur trimi rrëmbeu longarin
kënga e çobanit e përkuli barin.

E lidhën te shtrunga, e rrahën te stani,
këndoi për Naimin dhe nuk vdiq çobani.

SHOKUT TIM QË SHKRUAN PËR FËMIJË

Ai ka shokët më besnikë në shoqëri
ai i mba në vargje, kurse ata në sy.

Më shumë nga të gjithë miq ka ai,
miqt i ka çapkëna plot me pafajsi.

S'kanë ata trazira halle dhe shqetësime
konaku i fëmijve mbushur me gëzime.

Shkruan për ata, hap mbas vetes tonë,
këngë, e gaz mbajnë në buzën e njomë.

Venë i mbështeten te vargu i bukur,
si në prehër prindi, si në pëqi futur.

Hua u mori sylë, buzëqeshjet preu,
i futi në vargje, në ritme i ktheu.

Ai i mba në vargje, kurse ata në buzë,
vargu i tij valë, buz' e tyre shpuzë.

DISA ÇASTE ME VETERANIN

Veterani kish flokë si argjend
dhe ballë të lartë të patronditur
por në klasë kur mes nxënësish u gjend
iu duk se edhe vetë ish i parritur.

Tablotë në mur kujtimi i preku
si peneli i piktorit në përrallë
që lules aromë i jepte
që zogjtë i zbriste të gjallë.

Dhe ndjemë në atë çast erë baroti
trima që lirinë përshëndesin
dhe pamë përsëri veteranin
që fliste e sytë i qeshnin.

Ai zbriti shkallët ngadalë,
korridori mbeti i ndritshëm
dhe tablotë heshtën prapë në mur
si një pejsazh i palëvizshëm.

ME PESHKATARET

Në rrjetën e peshkimit mbeti mbrëmë
një rreze e hënës dhe një vargu im
me dritë e zhurmë i mbuluan valët
dhe s'u shkëputën dot gjer në agim.

Ndaj mengadalë u përkul pak hëna
ia zgjati dorën rrezes — bijë të saj
veç mua më kish dehur kaltërsia
dhe vargun tim nuk munda dot ta mbaj.

Merreni ju, o peshkatarë plot ëndërra
mbajeni pranë vargun tim të thjeshtë
nuk më vjen keq. Po jua fal nga zemra
ngrohni me të dorën e ftohtë në vjeshtë.

Veç e lëshoni ndonjë natë të bardhë
mbi kala kur tundet fleta e rrushit

kur mbi brigjet vala kompozon
melodi me vargjet e Lasgushit.

Të dëgjojë si fëshférinë erërat
midis jush mos ndjehet kurrë i huaj
t'ia njohë frymëmarrjen thellësisë
t'i rrahë theksi, siç rreh zemra juaj.

Sot peshkatarë kur t'i têrhiqni rrjetat
mbi valën e praruar në agim
mes peshqëve të argjentë do të gjeni
të dridhshmin, të kthjelltin vargun tim.

DIMRI NË QYTETIN TIM

*Nëna më shkruan: «Qyteti
është zbardhur i téri: Veç
liqeni s'do t'ia dijë buçet...».*

Qyteti im dasmat i bën në verë,
më të bardha vajzat i vesh nuse,
po dje dikush e mblodhi gjithë bardhësinë e
nuseve
dhe qytetit kur flinte ja hodhi mbi supe.

Qyteti im e çeli që pa gdhirë
syrin e thellë të kaltër, të hutuar
me hove dallgësh i shqetësuar pyeti:
Më paskan veshur për të nusëruar?

Dhe si çdo nuse qau pa u ndjerë
Ç'm'i ranë lotët faqeve e supeve

C'm'ju gris, ç'ju shkri vellua e hollë e bardhë
që rrrobaqepsja e panjohur hodhi rrugëve.

Mbrëmë në qytetin tim ra dëborë
e dini? Unë dëborën e dua
tani nëna ime shqetësohet mbi shtiza
thurëndërra dhe dorashka të ngrohta për
mua

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
<i>Agim Lleshi</i> — Kur del hëna mes shpatesh	3
Erërat fryjnë pranë bustit	5
Bardhësi	7
<i>Agim Pipa</i> — Kur ndërrojnë stinët	8
Motivet tona	9
Dashuria për heroin e panjohur	10
<i>Agron Agolli</i> — Kanan, djalë i ri	11
<i>Bardhyl Agasi</i> — Banorët, qyteti / dhe deti	15
Peshkatarët	16
Kur qeshin fëmijët	17
Jetë	18
<i>Demir Gjergji</i> — N.P. punëtor në hidrocentral	19
Tekstilistet	20
<i>Fatmir Harka</i> — Toka ime	21
Në ditëlindjen time	22
Para bustit të mësuesit Babë Dudë Karbunara	23
<i>Iliriana Sulkuqi</i> — Komandant	25
Të njëjtën këngë, të njëjtën melodi	26
Afrikë, mbledh dunat e urrejtjes	28
<i>Kastriot Mahilaj</i> — Parti	29
Motiv i lindur në shërbim	30

Faqe

Balladë e vogël për komisarin	31
<i>Merita Caci</i> — Shushica rrjedh e qetë	33
Hapat	34
Në baterinë bregdetare	35
<i>Mexhit Shqyipi</i> — Për motrën e vogël që këndon me çifteli.	36
<i>Muço Muho</i> — Bisedë me gjyshin	38
Pranë jush	40
Në lashtësi	41
<i>Myslym Maska</i> — Ndoshta	42
Armiqve të klasës	43
Lirikë	45
Peisazh pranveror	46
Kam njohur	47
Mekaniku	48
Kur shoh lulkuqe	49
<i>Odise Goro</i> — Dhe si shkëmb mbi shkëmb u ngrit ..	50
Përcjellje	52
Pejsazh nga bregdeti	53
Pse shushurin Vëlbona	54
<i>Petraq Risto</i> — Këngëtarit popullor Demir Zyko ..	55
Plakat.	58
Afrikë	60
<i>Ruzhdi Gole</i> — Betimi im	62
Kur iki nga Vlora	63
Pranverë	64
Skicë	65
Në mëngjeset e fundit	66
Kur jam me ty	67

	Faqe
<i>Sefer Pasha</i> — Gadishmëri	68
Sheshi i partizanëve	69
Kur u ngjita në Magulën e kaltër	71
<i>Selim Aliaj</i> — Drini i devijuar	73
Imazhe për Fierzën 1977	74
Ndryshe si mund të jesh poet?	75
<i>Spiro Sota</i> — Janë rritur pishat e tua, Resmi	79
Dhentë shtegtojnë drejt bjeshkëve	80
Mëngjes	81
<i>Syrja Xhelaj</i> — Pallzhveshur	82
Nuk harrojmë	84
Bacë Sokoli	86
<i>Vangjel Kozma</i> — Heroi dhe bukuria	88
Gërneta	89
<i>Vasil Dede</i> — Partizanit Aleks	90
Gurë dhe thëllënza	91
Vajzave në valle	92
Lirika e nënës	94
Kur erdhe ti	96
<i>Vasil Tabaku</i> — Sirena e parë në Mallakastër	98
Deshë të thoshja diçka	99
Viti 1920	101
Centralistes	103
<i>Zaho Puci</i> — Në udhën e dijes	105
Qyteti im	108
Erdhi pranvera	110
Net plugimesh	112
Çobani	114

Faqe

Shokut tim që shkruan për fëmijë	116
<i>Zhaneta Shqepa</i> — Disa çaste me veteranin	118
Me peshkatarët	120
Dimri në qytetin tim	122